

PRAPA EKRANEVE

**RAPORT VJETOR PËR GJENDJEN E
ÇRREGULLIMIT INFORMATIV**

Korrik, 2023

HIBRIDO.INFO

Prapa Ekранеve

Raport vjetor për gjendjen e çrregullimit informativ

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, korrik 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



AUTOR:

Plator Avdiu
Shkelzen Osmani

Kontrollues të fakteve:

Fatbardh Dema
Festim Rizanaj

Dizajni:

Festim Rizanaj



Visit our website
www.hibrid.info



Na gjeni në Facebook
[@hibridinfo](https://www.facebook.com/hibridinfo)



Na gjeni në Youtube
[@hibridinfo](https://www.youtube.com/hibridinfo)



Na gjeni në Twitter
[@hibridinfo](https://twitter.com/hibridinfo)



Na gjeni në LinkedIn
[@hibrid.info](https://www.linkedin.com/company/hibridinfo)

Zyrat tona:
Rruga Venet Bajrami, Hyrja B, Residio 5
Nr.10, Kati III
Prishtinë, 10000
Kosovë
+383 (0) 44 313 428
info@hibrid.info

PËRMBAJTTJA

7

Përfundim dhe rekomandime.....47

6

Rregullimi dhe vetërregullimi i mediave.....43

5

Praktika dhe mjedisi gazetaresk: rrethanat dhe konteksti.....41

4

Analiza e gjendjes së keqinformimit në Kosovë.....14

3

Konteksti politik dhe socio-ekonomik i çrregullimit informativ në Kosovë.....12

2

Konteksti mediatik i çrregullimit informativ në Kosovë.....10

1

Koncepti i çrregullimit informativ.....08

Ky raport monitorues dhe hulumtues pasqyron gjendjen e çrregullimit informativ gjatë periudhës janar-qershor 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – “hibrid.info”. Format i këtij raporti është monitorues e analitik dhe përshkruan gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 (janar-qershor 2023), ndërsa bënë analizë krahasimore edhe me 6 mujorin e fundit të vitit paraprak (korrik-dhjetor 2022), duke përfshi një periudhë një-vjeçare.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Qëllimi i këtij raporti është analizimi i çrregullimit informativ në Kosovë dhe mjedisit medial në vend. Në funksion të analizës dhe shqyrtimit të sfidave të çrregullimit informativ në Kosovë, raporti përbëhet prej tre pjesëve kryesore:

- Pjesa e parë shqyrton kontekstin medial të çrregullimit informativ dhe kontekstin politik e socio-ekonomik të mjedisit medial.
- Pjesa e dytë analizon gjerësisht gjetjet e monitorimit të periudhës gjashtëmujore të keqinformimit në Kosovë dhe krahasohen të dhënat me periudhën paraprake (korrik-dhjetor 2022).
- Pjesa e tretë trajton çështjet e rregullimit dhe vetërregullimit të mediave, si dhe mangësitë ligjore dhe institucionale që merren me rregullimin dhe vetërregullimin e mediave në Kosovë.

Monitorimi gjatë këtij gjashtëmujori tregon se temat politike kanë mbizotëruar duke qenë fusha më e trajtuar nga publikues dhe media të ndryshme në gjuhën shqipe (60%) e serbe (37%), të cilët

kanë krijuar dhe shpërndarë përmbajtje keqinformuese për zhvillimet politike në Kosovë. Dinamika e ngjarjeve në veri të Kosovës ka dominuar në artikujt e publikuesve në gjuhën shqipe (58%) dhe serbe (39%), si pjesë e narrativave dezinformuese për çështje politike. Veriu i Kosovës shfrytëzohet dukshëm nga mediat në gjuhën serbe (krahas atyre në gjuhën shqipe) sa i përket përmbajtjeve keqinformuese për Kosovën. Çështjet sociale janë temë e dytë më e trajtuar kryesisht nga publikuesit në gjuhën shqipe.

Vërehet tendenca e publikuesve në gjuhën shqipe për të krijuar më shumë përmbajtje të vlerësuara si “clickbait”, “lajm i rremë”, “mashtrim” dhe “gabim”[1] ku trajtohen përmbajtje sociale, kronika e zezë dhe politika. Ndërsa, mediat në gjuhën serbe kryesisht kanë publikuar “dezinformata”, “teori konspirative”, “manipulim të fakteve” dhe “përmbajtje të paverifikuar” të artikujve për zhvillimet politike dhe të sigurisë në Kosovë. Edhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë prodhuar artikuj keqinformues në fushën politike, megjithatë fokusi i tyre është më tepër në artikujt që trajtojnë çështje sociale dhe të kronikës së zezë.

Pos çrregullimit informativ, raporti dëshmon se mangësitë e identifikuara tashmë për kornizën ligjore të mediave, mungesa e kapaciteteve të mekanizmave të mediave, si dhe mangësitë tek mediat kosovare nuk janë adresuar ende. Këto dobësi, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikojnë që parandalimi dhe luftimi i çrregullimit informativ në Kosovë të vështirësohet edhe më shumë.

[1] Përkufizimi dhe domethënia e këtyre kategorive dhe keqinformimit shpjegohen në fjalorth.

I. KONCEPTI I ÇRREGULLIMIT INFORMATIV

Çrregullimi informativ, si nocion gjithëpërfshirës për keqinformimin, dezinformimin dhe lajmet e rreme, në literaturën profesionale dhe akademike, për herë të parë u përmend dhe u përkufizua si koncept nga autorët Claire Wardle dhe Hossein Derakhshan në një raport të botuar nga Këshilli i Evropës më 2017. Sipas tyre, çrregullimi informativ në vetvete manifestohet përmes tri formave kryesore: keqinformimit, dezinformimit dhe çinformimit (me qëllim për të shkaktuar dëm),[2] siç përmbledhen në vijim:

Keqinformimi

Shpërndarja e informacionit të rremë që nuk nënkupton se është i dëmshëm patjetër

Dezinformimi

Shpërndarja e informacionit të rremë në mënyrë të qëllimshme për të shkaktuar dëm

Çinformimi

Shpërndarja e informacionit të vërtetë për të shkaktuar dëm, shpeshherë duke transferuar informacionet private në sferën publike

Hulumtimet në rrafshin teorik, profesional dhe akademik të këtij fenomeni u vunë në qendër të vëmendjes, me theks të veçantë pas fushatës së referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për largim nga Bashkimi Evropian (i njohur ndryshe si Brexit) në qershor 2016 dhe fushatës së zgjedhjeve presidenciale në SHBA më 2016. Në këto dy ngjarje me rëndësi evropiane dhe globale u shpërndanë në masë të madhe lajme të rreme dhe dezinformata nga akterë të ndryshëm për qëllime manipulimi, përfshirë edhe nga ndikime të jashtme që shpeshherë i referohen si ndërhyrje nga ana e Ruisë[3] për të ndërhyrë ose ndikuar në ngjarje me peshë të madhe në atë kohë.

[2] Wardle, C., & Derakhshan, H. (2017). Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policymaking, f. 5. Strasbourg: Council of Europe.

[3] Conrad, M., & Hålfdanarson, G. (2023). Introduction: Europe in the Age of Post-Truth Politics. In M. Conrad, G. Hålfdanarson, A. Michailidou, C. Galpin, & N. Pyrhönen (Eds.), Europe in the Age of Post-Truth Politics: Populism, Disinformation and the Public Sphere (f. 1-9). Cham: Palgrave Macmillan. https://doi.org/10.1007/978-3-031-13694-8_1

Prej atëherë e deri më tash, çrregullimi informativ, i shprehur në forma të ndryshme, nuk konsiderohet më sfidë vetëm e një vendi, por është bërë pjesë e politikës në të gjithë botën dhe, sipas autorëve seriozë që merren me trajtimin teorik e akademik të këtij fenomeni, fatkeqësisht duket se është normalizuar në fjalorin dhe komunikimin politik.[4] Për më tepër, lajmet e rreme dhe mënyrat e tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.[5]

Për më tepër, lajmet e rreme dhe mënyrat e tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.[4]

Kjo qasje e kombinuar teorike, akademike dhe profesionale e trendeve të çrregullimit informativ është e rëndësishme për të kuptuar tendencat e këtij fenomeni në rajonin e Ballkanin Perëndimor, në përgjithësi, si dhe në Kosovë, në veçanti, i cili është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti me karakter monitorues dhe hulumtues për gjendjen e keqinformimit në Kosovë gjatë periudhës gjashtëmujore janar-qershor 2023.

Lajmet e rreme dhe mënyrat tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.

[4] Egelhofer, J. L., Aaldering, L., Eberl, J.-M., Galyga, S., & Lecheler, S. (2020). From Novelty to Normalization? How Journalists Use the Term "Fake News" in their Reporting. *Journalism Studies*, 21:10, 1323-1343. <https://doi.org/10.1080/1461670X.2020.1745667>

[5] Monsees, L. (2021). Information disorder, fake news and the future of democracy. *Globalizations*, 20:1, 153-168. [2](#)

II . KONTEKSTI MEDIATIK I ÇRREGULLIMIT INFORMATIV NË KOSOVË

Çrregullimi informativ në Kosovë zhvillohet kryesisht nga mediat online (portalet) që krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje keqinformuese në mënyrë të qëllimshme, apo të paqëllimshme. Duke vepruar në një kontekst të caktuar politik dhe në funksion të arritjes së përmbajtjeve të tilla mediatike tek lexuesit dhe audienca sa më e gjerë, mediat online janë të papenguara në shpërndarjen e çfarëdo informacioni dhe atë me një shpejtësi marramendëse që nuk është parë më herët.


Dalja në sipërfaqe e mediave sociale, mundësitë për përhapje të informacionit dhe përdorimi masiv i tyre nga mediat, publikuesit dhe përdoruesit e ndryshëm, ka mundësuar që përmbajtjet keqinformuese, pos lajmeve të sakta dhe informatave të konfirmuara, të arrijnë sa më shpejt tek lexuesit dhe përdoruesit e mediave sociale. Kjo ka nxitur krijimin e shumë mediave online në Kosovë në prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve të ndryshme, përfshirë edhe ato me përmbajtje keqinformuese.

Të dhënat e grumbulluara nga “hibrid.info” tregojnë se mediat online, pos që kanë prezencë online përmes faqeve në internet, ato kanë prani aktive në mediat sociale. Media sociale me ndikimin më të madh në Kosovë është Facebook, në të cilën shpërndahen gjerësisht publikimet e mediave dhe operatorëve të tjerë online që publikojnë përmbajtje me karakter keqinformues, ndërsa edhe TikTok shfrytëzohet nga mediat për shpërndarje të materialeve të keqinformimit, por Twitter dukshëm më pak.

Teknologjia e sotme mundëson publikimin dhe shpërndarjen e shpejtë dhe të lehtë të informacionit, por edhe përdoruesit dhe publiku i gjerë të bien pre e çrregullimit informativ. Kjo vështirëson mbikëqyrjen, kontrollin dhe eventualisht sanksionimin e mediave dhe faqeve online që shpërndajnë publikime keqinformuese. Kjo është nga sfidat kryesore të identifikuara në raportet e organizatave ndërkombëtare, të cilat kritikojnë për mangësi në legjislacionin aktual, i cili nuk rregullon veprimtarinë e mediave online. Vërejtjet e vazhdueshme të Komisionit Evropian (KE) për ndryshime në legjislacion për rregullimin e mediave online dhe harmonizimit me Direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian (BE)

për mediat audiovizuale[6] janë marrë parasysh vetëm pjesërisht nga institucionet e Kosovës. Në këtë drejtim ka progres shumë të vogël sepse projektligji për rregullimin e kësaj çështje është në procedurë të draftimit dhe nuk është miratuar ende[7]. Sfidë në vete duket se përbëjnë edhe kapacitetet e mekanizmave aktualë rregullues (Komisioni i Pavarur i Mediave) dhe vetërregullues të mediave në Kosovë (Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës) që ballafaqohen me burime të pamjaftueshme financiare dhe profesionale.[8]

Siç dihet, që nga viti 2020 në Kosovë nuk shtypen më gazeta dhe publiku kosovar më së shumti informohet nga mediat online marrë parasysh shkallën e depërtimit të internetit në Kosovë dhe nga televizionet, si formë tradicionale e informimit. Anketimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në muajin tetor të vitit 2022, tregojnë për një depërtim pothuajse absolut të internetit në Kosovë prej 97.9%.[9]



98%

**Depërtimi i internetit
në Kosovë**

[6] European Commission. (2022). Kosovo 2022 Report, fq. 33-34. Brussels: European Commission.

[7] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[8] Mekanizmat rregullues dhe vetërregullues të mediave trajtohen në një seksion të veçantë në këtë raport.

[9] Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2022). Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2022, f. 9. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

III. KONTEKSTI POLITIK DHE SOCIO-EKONOMIK I ÇRREGULLIMIT INFORMATIV NË KOSOVË

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore të gjendjes së keqinformimit në Kosovë ka pasur lëvizje të ndryshme sa i përket përmbajtjeve keqinformuese që ishin cak i çrregullimit informativ brenda dhe jashtë vendit. Përmbajtjet keqinformuese në këtë periudhë janë dominuar nga publikime për çështje politike dhe sociale, në varësi të zhvillimeve gjatë këtyre gjashtë muajve. Ngjashëm si në periudhën paraprake gjashtëmuajore (korrik-dhjetor 2022)[10], edhe në këtë periudhë kanë mbizotëruar publikimet në fushën politike me 25% dhe pas tyre renditen përmbajtjet në fushën sociale me 21%, ku dallimi mes tyre është prej 4%.

Përfshirja e mediave sociale në monitorimin e përmbajtjeve keqinformuese për këtë periudhë ka ndikuar që, pos temave politike, të ketë përqindje të lartë të artikujve në fushën sociale. Edhe mediat reale dhe portalet e dyshimta në gjuhën shqipe kanë publikuar më shumë artikuj keqinformues me tematikë sociale që pasohen nga temat politike. Por, arsyeja e dominimit të temave politike në tërësi qëndron në faktin se një pjesë e konsiderueshme artikujve keqinformues të mediave në gjuhën serbe janë në fushën politike dhe rrjedhimisht kjo e ka vendosur fushën politike si mbizotëruese mbi fushat tjera. Kjo ndërlikohet veçanërisht me zhvillimet e tensionuara në veriun e Kosovës gjatë muajit qershor 2023, ku përveç publikuesve në gjuhën shqipe, edhe mediat në gjuhën serbe, kanë krijuar dhe shpërndarë pretendime të pabaza në kuadër të narrativave dezinformuese për çështje politike dhe të sigurisë për veriun e vendit.

Dallimi mes publikimeve keqinformuese në fushën sociale e të kronikës së zezë dhe atyre në fushën politike e të sigurisë është se, për këto të fundit, kanë publikuar jo vetëm mediat në gjuhën shqipe, por edhe ato serbe. Mediat në gjuhën serbe, të gjitha përmbajtjet keqinformuese për Kosovën gjatë periudhës janar-qershor 2023 i kanë krijuar dhe shpërndarë në fushën politike dhe të sigurisë, derisa ato në gjuhën shqipe kanë qasje krejtësisht ndryshe dhe publikimet e tyre janë të shumëllojshme, qoftë për aspekte sociale, kronikë të zezë, politikë, siguri, shpallje, sport,

[10] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022, f. 17. Prishtinë: ADS / hibrid.info.

showbiz etj. Për këtë arsye, kategoria keqinformuese që ka mbizotëruar më së shumti në këtë periudhë është “Clickbait”, e cila pasohet nga kategoria “Dezinformatë”.[11]

Përmbajtjet keqinformuese në fushën politike kanë qenë të fokusuara në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës e Serbisë, ngjarjet në veri të Kosovës, komunitetin serb, pretendimet e pabaza të mediave serbe se komuniteti serb në Kosovë është nën kërcënime të institucioneve të Kosovës, se po përgatit plan për dëbim të serbëve nga veriu i Kosovës etj. Ndërsa, publikimet shtrembëruese me tematikë sociale kanë trajtuar çështje të ndryshme, si pretendime të rreme nga publikuesit në gjuhën shqipe për dhurim pasurie, lidhje dashurie, rritja e çmimeve, mbështetje financiare, programi televiziv “Big Brother VIP Albania” (“BBVA”) etj.

Publikimet shtrembëruese me tematikë politike, të shpërndara nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe, kanë trajtuar më së shumti marrëdhëniet Kosovë-Serbi, veriun e Kosovës, komunitetin me shumicë serbe në Kosovë, pretendimet e pabaza të mediave serbe se komuniteti serb në Kosovë është nën kërcënime të institucioneve të Kosovës, se po përgatit plan për dëbim të serbëve nga veriu i Kosovës etj.

[11] Shih seksionin përkatës ku analizohen këto dy kategori kryesore të keqinformimit në raport.

IV. ANALIZË E RAPORTEVE MUJORE

Çrregullimi informativ është emëruesi i përbashkët për lloje e mënyra të ndryshme të keqinformimit. Me qëllim të përfshirjes së të gjitha mënyrave dhe formave në të cilat ai zhvillohet, “hibrid.info” e ka ndarë keqinformimin në disa kategori vlerësimi, bazuar edhe në metodologjinë e punës, të pranuar nga Rrjeti Ndërkombëtar për Kontrollimin e Fakteve (International Fact-Checking Network – IFCN), si në vijim[12]:

Ky klasifikim shërben për të sistemuar keqinformimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe për të kuptuar në thelb se si ai përçohet e degëzohet, duke na ndihmuar të mësojmë më shumë për:

Clickbait

Dezinformatë

Gabim

Lajm i rremë

Manipulim i fakteve

Mashtrim

Përmbajtje e paverifikuar

Teori konspirative

Kontekstin

Qëllimet

Akterët dhe institucionet e përfshira në keqinformim

[12] Këtu janë renditur vetëm ato kategori vlerësimi të cilat shfaqen në raportet mujore. Për t'i parë të gjitha kategoritë, shih metodologjinë e “hibrid.info” këtu: <https://hibrid.info/metodologjia/>

Për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2023, "hibrid.info" ka publikuar gjashtë raporte mujore monitoruese[13] për gjendjen e keqinformimit në Kosovë. Synimi është të jepet një sqarim më objektiv rreth gjendjes së informimit dhe të shpjegohen tendencat e keqinformimit për periudhën monitoruese. Platforma "hibrid.info" krahason të dhënat mbi çrregullimin informativ në çdo raport mujor të grumbulluara nga baza e të dhënave përmes tetë kategorive krahasuese të cilat analizohen në raport.

1

Kategoritë për vlerësimin e keqinformimit

2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

3

Fushat në të cilat u shpërndan përmbajtje keqinformuese.

4

Llojet e publikuesve që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese.

5

Publikuesit në gjuhën shqipe dhe serbe

6

Llojet e mediave sociale

7

Publikuesit në mediat sociale

8

Institucionet dhe personalitetet e përfolura

[13] Raportet mujore të publikuara nga "hibrid.info" gjenden këtu: <https://hibrid.info/raportet-mujore-monitoruese/>.

1. KATEGORITË VLERËSUERE TË KEQINFORMIMIT

Ky seksion analizon artikujt me përmbajtje keqinformuese varësisht prej kategorive vlerësuese të keqinformimit dhe përmes tyre kuptohen më qartë trendet e keqinformimit si pjesë e çrregullimit informativ. Metodologjia e “hibrid.info” përcakton kriteret se cilat janë kategoritë e vlerësimit të publikimeve keqinformuese dhe në çfarë mënyre një artikull i caktuar keqinformues mund të vlerësohet[14].

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, vërehet se artikujt e vlerësuar në kategorinë “Clickbait”[15] me 25% kanë mbizotëruar më së shumti në krahasim me kategoritë tjera. Rrjedhimisht, operatorë e media të ndryshme të monitoruara kanë publikuar më së shumti artikuj në këtë kategori dhe në vendin e dytë janë publikimet e kategorisë “Dezinformatë”[16] me 21%.

Monitorimi përgjatë kësaj periudhe tregon se këto dy kategori kanë mbizotëruar pothuajse vazhdimisht edhe në raportet mujore, me përjashtim të muajit prill 2023, kur kishte pasur shumë më pak publikime të vlerësuara si dezinformata[17] dhe dhe ishin renditur në vendin e katërt. Ndërsa, kategoria clickbait, gjatë muajit qershor

2023, pësoi rënie drastike në vendin e katërt, si pasojë e dominimit në masë të madhe të temave politike të sigurisë për shkak të ngjarjeve në komunat veriore të Kosovës. Gjetjet e monitorimit tregojnë se në muajin qershor 2023 asnjëra prej këtyre dy kategorive nuk ishte në vendin e parë, për shkak se lajmet e rreme ishin në vendin e parë (24%), dezinformatat në të dytin (19%), pasuar nga përmbajtjet e paverifikuara (me 15%) dhe clickbait në vendin e katërt (me 11%).

Përmbajtjet keqinformuese që kanë marrë vlerësime të tjera në këtë gjashtëmujor përfshijnë kategorinë “Lajm i rremë” (13%), “Mashttrim” (12%), “Përmbajtje e paverifikuar” (10%) dhe kategori të tjera.

[14] Metodologjia e “hibrid.info” për kontrollin e fakteve dhe luftimin e dezinformatës e lajmeve të rreme gjendet këtu: <https://hibrid.info/metodologjia/>.

[15] Përkufizimi dhe domethënia e kategorisë “Clickbait” shpjegohet në fjalorth.

[16] Përkufizimi dhe domethënia e kategorisë “Dezinformatë” shpjegohet në fjalorth.

[17] Shih raportin monitorues për muajin prill 2023 të publikuar nga ADS/hibrid.info këtu: <https://hibrid.info/raporti-monitorues-i-keqinformimit-per-muajin-prill-2023/>.




Fig 1. Publikimet keqinformuese sipas kategorive të vlerësimit gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmujore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Marrë parasysh se ky është raporti i dytë monitorues[18] për gjendjen e keqinformimit në Kosovë dhe me qëllim të krahasimit të të dhënave mes dy periudhave gjashtëmujore, në raport krahasohen të dhënat e monitorimit për keqinformimin. Edhe në periudhën parapake gjashtëmujore, kategoritë kryesore kanë qenë clickbait dhe dezinformata, por vërehet qartë se pub-

-likimet keqinformuese të vlerësuara si dezinformata me 28% kishin mbizotëruar në vendin e parë ndaj publikimeve me vlerësime clickbait me 25% (3% më shumë në raport me clickbait). Kjo është përmbysur në gjashtëmujorin e këtij viti (janar-qershor 2023), kur dezinformatat ishin gjithmonë pothuajse në vendin e dytë pas kategorisë clickbait.




Fig 2. Publikimet keqinformuese sipas kategorive të vlerësimit në dy periudhat gjashtëmujore

[18] Shih raportin e parë "Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022". ADS/hibrid.info, janar 2023.

Shqyrtimi i të dhënave në baza mujore tregon se dezinformatat kishin vazhduar të mbizotërojnë edhe gjatë muajit janar 2023, si vazhdimësi e tendencës së muajit dhjetorit 2022, por nga muaji shkurt e deri në fund të kësaj periudhe gjashtëmujore (qershor 2023) ato kanë rënë në vendin e dytë.

Arsyeja për rënien e publikimeve keqinformuese në këtë kategori gjatë muajve vijues qëndron në faktin se dezinformatat kryesisht shpërndahen për çështje politike dhe të sigurisë në kontekst të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, përmes të cilave ndërtohen narrativa njëburimore, pa konfirmim dhe plotësim me burime tjera të dhënash, përmbajnë gjysmë të vërteta apo kanë tituj që nuk pasqyrojnë përmbajtjen e tekstit sa i përket saktësisë së informacionit[19].

Në kuadër të dezinformatave publikohen dhe shpërndahen edhe tema keqinformuese në fusha të tjera jashtë sferës politike dhe të sigurisë (siç janë temat sociale, kronika e zezë, moti, sporti etj.), por në përqindje jashtëzakonisht më të ulët në raport me politikën dhe sigurinë, sepse të dhënat nga monitorimi tregojnë se këto dy fusha së bashku përbëjnë 54% ose më shumë se gjysmën e dezinformatave të

shpërndara për këtë periudhë gjashtëmujore.

Me rënien e numrit të raportimeve keqinformuese për këto dy fusha tematike (politikë dhe siguri), rrjedhimisht bie edhe numri i publikimeve në kategorinë e dezinformatës në njërën anë dhe rriten publikimet clickbait dhe në kategoritë tjera, në anën tjetër, siç konfirmohet edhe në muajt vijues nga shkurti deri në qershor të vitit 2023. Madje gjatë muajit prill 2023, kishte shumë më pak dezinformata në krahasim me muajt e tjerë të këtij gjashtëmujori, si pasojë e mungesës së keqinformimeve për politikën dhe sigurinë (kjo konfirmohet edhe nga Figura 5), duke e vënë këtë kategori në vendin e katërt me 12% gjithsej, pas kategorive clickbait, lajm i rremë dhe përmbajtje e paverifikuar[20]. Por, në muajt vijues (maj dhe qershor 2023), vërehet rritje e dezinformatave si rrjedhojë e shpërndarjes më të shpeshtë të artikujve keqinformues për politikë dhe siguri në vazhden e dinamikës së ngjarjeve në veri të Kosovës.

Një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, por edhe në atë paraprake, janë krijuar dhe shpërndarë

[19] Shih metodologjinë e “hibrid.info” për kontrollin e fakteve.

[20] Shih raportin monitorues për muajin prill 2023 të publikuar nga ADS/hibrid.info këtu: <https://hibrid.info/raporti-monitorues-i-keqinformimit-per-muajin-prill-2023/>.

nga mediat në gjuhën serbe. Këto të fundit kanë krijuar narrativë keqinformuese lidhur me komunitetin serb në Kosovë, veriun e Kosovës, pretendime të pasakta për kërcënimin eserbëve nga institucionet e shtetit të Kosovës, raportet e tendosura politike Kosovë-Serbi etj. Publikime të tilla të narrativave dezinformuese bëhen kryesisht nga mediat serbe të afërta me pushtetin në Serbi[21] pa u bazuar në saktësim apo verifikim të fakteve dhe burimeve të informacionit me qëllim të dezinformimit për ngjarje për dhe rreth Kosovës, kryesisht në raport me çështje politike e të sigurisë.

Gjatë periudhës gjashtëmujore, pjesa më e madhe e përmbajtjes keqinformuese në kategorinë e dezinformatës u publikua nga publikuesit në gjuhën shqipe (portale të dyshimta me 37%, mediat sociale me 31% dhe mediat reale 5%). Prej tyre, 73% janë publikuar nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe 27% nga mediat reale në gjuhën serbe (në gjuhën serbe maten vetëm mediat reale, por jo edhe mediat sociale dhe portalet e dyshimta, rrjedhimisht përqindja e dezinformatave është më e ulët tek këto media).




Fig 3. Fushat në të cilat kishte pasur më së shumti keqinformime në kategorinë "Dezinformatë" gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

[21] Đurđević, M. (17 gusht 2021). Mediji u Srbiji oznaku 'saradnici Vlade' vide kao Tviter 'žigovanje'. Radio Slobodna Evropa.

Sa i përket keqinformimeve në kategorinë clickbait, siç u konstatua më sipër, ato kanë dominuar gjatë tërë kësaj periudhe gjashtëmujore, me përjashtim të muajve janar dhe qershor 2023 (shih Figurën 5).[22] Në kuadër të kësaj kategorie vlerësimi, vërehet tendenca që kryesisht të krijohen e shpërndahen keqinformime për kronikën e zezë dhe çështjet sociale që nxisin kureshtjen e lexuesve dhe publikut të gjerë, siç janë raportimet keqinformuese për vrasje, aksidente, arrestime, plagosje, vetëvrasje, programin televiziv “BBVA”, tërheqjen e mjeteve materiale nga Trusti, rritja e çmimeve, ndihma të ndryshme financiare etj. Vlerësime clickbait kanë marrë edhe fusha të tjera tematike, megjithatë kronika e zezë dhe problematikat sociale mbizotërojnë mbi fushat e tjera (si politika, siguria, moti, sporti etj.). Një tendencë e tillë konstatohet nga të dhënat e Figurës 4, ku temat më së shumti të krijuara e të shpërndara nga media të ndryshme

janë për kronikën e zezë dhe çështjet sociale prej 69% gjithsej që të dyja këto fusha.

Monitorimi i artikujve keqinformues në kategorinë clickbait ka nxjerrë në sipërfaqe se të gjitha publikimet në këtë kategori janë shpërndarë nga mediat në gjuhën shqipe. Vërehet se mediat në gjuhën shqipe që publikojnë artikuj keqinformues në këtë kategori kanë nevojë të fitojnë më shumë audiencë në formatin online. Publikuesit e këtyre lajmeve në përqindjen më të madhe janë mediat reale në gjuhën shqipe me 68%, të cilat pasohen nga faqe e profile të ndryshme në mediat sociale prej 20% dhe portale ose operatorë të dyshimtë prej 12%. Mund të thuhet se mediat që publikojnë artikuj të tillë keqinformues nuk e kanë domosdoshmërisht tendencën ose qëllimin që të keqinformojnë, por e bëjnë kryesisht për rritjen e audiencës në mediat sociale dhe mundësinë e përfitimeve financiare përmes klikimeve.




Fig 4. Fushat në të cilat kishte pasur më së shumti keqinformime në kategorinë "Clickbait" gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

[22] Shih [metodologjinë](#) e "hibrid.info" për kontrollin e fakteve.

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmuajore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Krahasimi i të dhënave të këtij gjashtëmuajori (janar-qershor 2023) me periudhën paraprake (korrik-dhjetor 2022) tregon për disa dallime në aspektin e krijimit të përmbajtjeve keqinformuese mes këtyre dy kategorive kryesore të keqinformimit, si pjesë e çrregullimit informativ. Derisa në periudhën janar-qershor 2023, kategoria "Clickbait" kishte dominuar pothuajse në të gjithë muajt (përveç muajit janar), në periudhën gjashtëmuajore korrik-dhjetor 2022, edhe pse kanë mbizotëruar dezinformatat, megjithatë nga monitorimi mujor dhe siç konfirmohet

në Figurën 5, vërehet një luhajtje mes dezinformatave dhe kategorisë clickbait, duke qenë herë njëra e herë tjetra në vendin e parë, përkatësisht të dytë. Kjo shpjegohet me faktin se zhvillimet politike dhe të sigurisë në lidhje me veriun e Kosovës dhe marrëdhëniet Kosovë-Serbi kishin diktuar raportimet mediale për dezinformata dhe clickbait, veçanërisht gjatë muajve korrik dhe dhjetor 2022 kur kishte pasur dinamikë më të theksuar të këtyre zhvillimeve politike, të cilat kishin ndikuar të ketë më tepër dezinformata sesa clickbait.




Fig 5. Krahasimi i kategorive "Dezinformatë" dhe "Clickbait" mes dy periudhave gjashtëmuajore

2. TEMAT E PËRDORURA PËR KRIJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E PËRMBAJTJEVE KEQINFORMUESE

Ngjashëm si në periudhën paraprake gjashtëmujore, edhe gjatë këtij gjashtëmujori, veriu i Kosovës me 10% ka qenë tema kryesore mbi të cilën janë krijuar dhe shpërndarë keqinformime nga media të ndryshme. Nëse veriut i shtohet edhe tema e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë (4%), atëherë të dyja këto bashkë përbëjnë 14% të publikimeve gjatë këtyre gjashtë muajve. Në këto përmbytje keqinformuese, mediat kryesisht kanë plasuar artikuj me tematikë politike dhe të sigurisë në kontekst të zhvillimeve në veriun e vendit lidhur me tensionet e herëpashershme, si dhe shtrembërimin e situatës për gjendjen e komunitetit serb në atë pjesë të vendit.

Kjo mund t'i atribuohet jo vetëm zhvillimeve lidhur me këtë temë, por edhe faktit se Qeveria e Kosovës e ka vënë si prioritetin kryesor dialogun Kosovë-Serbi, ku veriu është pjesë kyçe e dialogut, si dhe debateve në televizionet me frekuenca kombëtare në Kosovë, të cilat i kushtojnë një rëndësi të madhe debateve politike dhe veriu është pjesë e pashmangshme e këtyre debateve nga komentues e analistë të ngjarjeve politike. Të dy këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi edhe të krijohen e shpërndahen keqinformime për veriun nga mediat në gjuhën shqipe[23]. Përveç kësaj, edhe mediat në gjuhën serbe, në formë të vazhdueshme,

publikojnë keqinformime për veriun e Kosovës duke pretenduar pa fakte dhe pa verifikim të informacioneve se qytetarët serbë në veri diskriminohen, frikësohen dhe kërcënohen nga institucionet shtetërore të Kosovës. Publikimet e mediave në gjuhën serbe kryesisht vlerësohen si dezinformata, teori konspirative, manipulim i fakteve dhe përmbytje e paverifikuar. Në pikëpamje statistikore, 58% e keqinformimeve për veriun janë krijuar e shpërndarë nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe 39% nga mediat në gjuhën serbe.

Një temë tjetër e trajtuar për shpërndarje të përmbytjeve keqinformuese janë raportimet e vazhdueshme të mediave në gjuhën shqipe për vrasje të ndryshme prej 5%. Këto publikime kryesisht kanë marrë vlerësime clickbait dhe e përbashkëta e tyre është se në tituj nuk është e qartë vendndodhja e këtyre vrasjeve, por në përmbytje të tekstit qartësohet se ato nuk kanë ndodhur në Kosovë. Për më tepër, publikime të tilla janë shpeshtuar nga mediat në gjuhën shqipe, të cilat mund t'i dezinformojnë lexuesit se ngjarje të tilla kanë ndodhur në Kosovë. Tema të tjera që kanë shërbyer për krijim të publikimeve keqinformuese janë edhe ato për programin televiziv "BBVA", tërmetin në Turqi, dhurim të pasurisë etj.

[23] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.




Fig 6. Temat kryesore të keqinformimit gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmuajore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Tema e veriut të Kosovës ka mbizotëruar gjatë të dyja periudhave gjashtëmuajore në bazë të gjetjeve të monitorimit nga “hibrid.info”. Megjithatë, në periudhën korrik-dhjetor 2022, media të ndryshme e kishin trajtuar më shumë veriun prej 12% se sa në periudhën pasuese janar-qershor 2023 me 10%. Ajo që dallon mes këtyre dy periudhave është tek trajtimi i temave të tjera për krijim e shpërndarje të përmbajtjeve keqinformuese. Gjatë

periudhës paraprake gjashtëmuajore, çmimet, skemat sociale, liberalizimi i vizave e tema të tjera ishin trajtua në masë të madhe në atë kohë për shkak të aktualitetit të tyre, derisa kjo kishte ndryshuar gjatë periudhës janar-qershor 2023, ku vrasjet, programi televiziv “BBVA”, tërmeti në Turqi dhe përmbajtje të tjera keqinformuese kishin qenë ndër temat më të trajtuara pas veriut.




Fig 7. Krahasimi i trajtimit të temave kryesore të keqinformimit nga mediat mes dy periudhave gjashtëmuajore

3. FUSHAT E KEQINFORMIMIT

Ngjashëm si me temat e keqinformimit, ku veriu i Kosovës, si temë politike, ka mbizotëruar në këtë periudhë gjashtëmujore, të dhënat e monitorimit shpërfaqin se edhe numri më i madh i artikujve keqinformues të publikuar gjatë këtyre gjashtë muajve janë në fushën politike me 25%. Në vendin e dytë janë keqinformimet në fushën soc-

-iale me 21% dhe dallimi me fushën politike është prej 4%. Një nga risitë e këtij raporti janë artikujt keqinformues për kronikën e zezë, ku 18% e artikujve të monitoruar janë në këtë fushë, ndërsa përmbajtjet keqinformuese për sigurinë janë tek në vendin e katërt me 16%.




Fig 8. Fushat kryesore të keqinformimit gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Përmbajtjet keqinformuese në fushën politike janë vlerësuar kryesisht si dezinformatë, lajm i rremë dhe clickbait, ndërsa ato me tematikë sociale kanë marrë vlerësime clickbait, mashtrim dhe dezinformatë. Edhe publikimet në kronikën e zezë kanë marrë më së shumti vlerësime clickbait kundrejt fushës së sigurisë që janë vlerësuar si

dezinformata, lajme të rreme dhe përmbajtje e paverifikuar.

Karakteristikë dalluese e këtyre fushave tematike është se pothuajse të gjitha publikimet me përmbajtje keqinformuese në fushën sociale dhe të kronikës së zezë janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat në gjuhën

shqipe. Ndërkaq, 47% e artikujve në fushën e sigurisë janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe dhe 50% nga publikuesit në gjuhën shqipe. Kurse, publikimet në fushën politike janë publi-

-kuar e shpërndarë më së shumti nga publikuesit në gjuhën shqipe (rreth 60%) dhe pjesë tjetër nga mediat në gjuhën serbe (37%).




Fig 9. Vlerësimi i artikujve keqinformues sipas kategorive të keqinformimit në bazë të fushave tematike gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmuajore (shtator-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Sa i përket fushave tematike mbi të cilat media të ndryshme kanë krijuar dhe shpërndarë artikuj keqinformues ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet këtyre dy periudhave gjashtëmuajore dhe krahasimi i të dhënave nga monitorimi e konfirmon këtë tendencë. “Hibrid.info” ka nisur matjen e “fushave të artikujve keqinformues” vetëm që nga muaji shtator 2022, kështu që të dhënat për matjet e kësaj kategorie përgjatë muajve korrik e gusht 2022

mungojnë. Matjet për muajt shtator-dhjetor 2022 tregojnë se përmbajtjet keqinformuese në fushën politike kanë mbizotëruar në formë të pakrahasueshme mbi fushat tjera me 40% gjithsej në vendin e parë, pasuar nga fusha sociale me 22%, siguria me 16% dhe sporti me 9%. Ndërsa, në këtë periudhë gjashtëmuajore (janar-qershor 2023) vërehet një ndryshim i dukshëm, ku artikujt në fushën sociale janë renditur në vendin e parë me 23% dhe

ato të politikës me 22%. Gjetje tjetër me rëndësi është se mediat në gjuhën shqipe kanë publikuar më shumë artikuj për kronikën e zezë këtë periudhë (në krahasim me periudhën paraprake) me 20% gjithsej, ndërsa fusha e sigurisë është renditur e katërta me 13%. Këto dallime të dukshme ndërmjet dy periudhave mund të arsyetohen përmes tendencës që mediat në gjuhën shqipe

kanë publikuar më shumë artikuj të vlerësuar si clickbait, të cilat për pasojë kanë rritur numrin e publikimeve në fushën sociale dhe të kronikës së zezë. Ndërkaq, kishte shumë më pak artikuj në kategorinë e dezinformatës dhe kategorive tjera që nënkupton edhe më pak publikime keqinformuese në fushën politike dhe të sigurisë.




Fig 10. Krahasimi i fushave kryesore të keqinformimit nga mediat mes dy periudhave gjashtëmuajore

4. LLOJET E PUBLIKUESVE TË KEQINFORMIMIT

Në raportin e parë gjashtëmujor që përfshin periudhën korrik-dhjetor 2022, "hibrid.info" ka matur llojet e publikuesve (operatorëve që publikojnë e shpërndajnë përmbajtje keqinformuese ose mediave) në media reale dhe portale të dyshimta.

Përveç këtyre llojeve të publikuesve, "hibrid.info" që nga muaji janar 2023 mat edhe mediat sociale, më saktësisht faqe, kanale e profile të ndryshme që publikojnë përmbajtje keqinformuese për Kosovën në media të ndryshme sociale (Facebook, TikTok, Twitter, YouTube etj.).

Kjo është e një rëndësie të veçantë marrë parasysh përdorimin e tyre të gjerë jo vetëm nga mediat dhe publikuesit e përmbajtjeve keqinformuese, por edhe nga lexuesit dhe audienca e gjerë në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhë gjashtëmujore (janar-qershor 2023), mediat reale kanë shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese për zhvillimet në Kosovë prej 46%. Ato pasohen nga faqe e profile në mediat sociale prej 38% dhe portalet e dyshimta me 16%.




Fig 11. Llojet e publikuesve (mediave dhe operatorëve) që kanë shpërndarë artikuj keqinformues gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Në figurën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të detajuar se cili ka qenë fokusi i publikuesve të ndryshëm, përfshirë mediat, në përhapjen e keqinformimit në Kosovë gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Vërehet se mediat reale

kanë shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në kategorinë clickbait, në mediat sociale janë shpërndarë më së shumti lajme të rreme dhe portalet e dyshimta kanë shpërndarë kryesisht dezinformata.




Fig 12. Shpërndarja e përmbajtjeve keqinformuese nga publikuesit në bazë të kategorive vlerësuese të keqinformimit gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Të dhënat në vijim konfirmojnë tendencën se gjatë kësaj periudhë gjashtëmujore, publikues të ndryshëm kanë krijuar e shpërndarë më së shumti

përmbajtje keqinformuese për tema politike, pasuar nga çështjet sociale dhe kronika e zezë. Artikuj keqinformues në fushën e sigurisë kishte shumë më pak.




Fig 13. Shpërndarja e përmbajtjeve keqinformuese nga publikuesit në bazë të fushave tematike gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmuajore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Mediat reale kanë publikuar më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese në të dyja periudhat gjashtëmuajore. Gjatë periudhës paraprake nuk ishin matur mediat sociale dhe për pasojë përqindja e publikimeve keqinformuese tek mediat reale (53%) dhe portalet e dyshimta (47%) ishte më e lartë. Ndërkaq, me përfshirjen e mediave sociale, vërehet një rënie e madhe e publikimeve tek portalet e dyshimta (16%), të cilat dalin në vendin e tretë dhe rënia nën 50% e publikimeve në mediat reale, marrë

parasysh se mediat sociale janë shfrytëzuar për publikim të materialit keqinformues nga faqe e profile të ndryshme prej 38%. Nga monitoruesit vërehet edhe një fakt tjetër për rënien e publikimeve keqinformuese nga portalet e dyshimta. Një pjesë e tyre janë shndërruar në faqe tjera me karakter komercial, një pjesë tjetër e kanë zvogëluar aktivitetin, ndërsa disa të tjera kanë filluar të shpërndajnë më shumë materiale që ndërlidhen me fushën e showbiz-it dhe thashethemeve.




Fig 14. Krahasimi i llojeve të publikuesve (mediave dhe operatorëve) që kanë shpërndarë artikuj keqinformues gjatë dy periudhave gjashtëmuajore

5. PUBLIKIMET KEQINFORMUESE TË PUBLIKUESVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Aktivitetet monitoruese tregojnë se përmbajtjet keqinformuese për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë publikohen më së shumti në gjuhën shqipe dhe serbe, përderisa publikues në gjuhë të tjera krijojnë e shpërndajnë shumë më pak keqinformime për Kosovën. Nga janari i vitit 2023, platforma "hibrid.info" ka bërë disa ndryshime në metodologjinë e monitorimit me qëllim të matjes së publikimeve keqinformuese kryesisht nga publikues në gjuhën shqipe dhe serbe.

Publikimet në gjuhën shqipe maten nga të gjithë publikuesit që përfshijnë: i) mediat reale, ii) faqe dhe profile të ndryshme në mediat sociale dhe iii) portalet e dyshimta. Ndërkaq, për artikujt keqinformues nga publikuesit në gjuhën serbe maten vetëm mediat reale në gjuhën serbe, sepse ato janë edhe krijuesit dhe shpërndarësit kryesorë të përmbajtjeve keqinformuese për Kosovën.[24]

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore (janar-qershor 2023), publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues prej gjithsej 81%, duke llogaritur këtu të gjitha llojet e publikuesve në gjuhën shqipe (media reale me 29%, faqet e ndryshme në mediat sociale me 36% dhe portalet e dyshimta me 16%). Publikimet në gjuhët

tjera përfshijnë ato në gjuhën serbe, ku të gjitha prej tyre janë publikuar në mediat reale në gjuhën serbe prej 17% dhe nga mediat në gjuhë të tjera (anglisht dhe rusisht) prej 2%, që kryesisht janë faqe në mediat sociale.

Përqindja e lartë e publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe përqindja e ulët e artikujve nga mediat në gjuhën serbe mund të shpjegohet nga dy arsye: i) përfshirja e mediave sociale në matjet e artikujve keqinformues ka rritur vetvetiu publikimet në gjuhën shqipe dhe ii) në publikimet në gjuhën serbe maten vetëm mediat reale në gjuhën serbe (por jo edhe mediat sociale dhe portalet e dyshimta). Këta dy faktorë kanë ndikuar që të ketë përqindje shumë më të lartë të publikimeve në gjuhën shqipe gjatë kësaj periudhe.

Në figurën e mëposhtme, por edhe në figurat tjera të këtij nën-seksioni të raportit krahasohen vetëm të dhënat mes publikimeve të mediave reale në të dyja gjuhët, gjuhën shqipe dhe serbe. Vërehet se pothuajse 2/3 e publikimeve të mediave reale (65%) janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa mbi 1/3 (ose 35%) e tyre nga mediat reale në gjuhën serbe.

[24] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022. Prishtinë: ADS / hibrid.info. Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat monitoruese të platformës "hibrid.info" për periudhën janar-qershor 2023.




Fig 15. Publikimet keqinformuese të mediave reale në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe (janar-qershor 2023)

Publikimet e mediave reale në gjuhën shqipe dhe serbe sipas kategorive të keqinformimit, konfirmon tendencën se mediat reale në gjuhën shqipe publikojnë më tepër artikuj keqinformues si clickbait (38%), gabim (9%) ose përmbajtje e paverifikuar (9%), por shumë më pak përmbajtje keqinfor-

-uese të vlerësuara si dezinformata (2%) apo lajme të rreme (1%). Përkundrazi, mediat reale në gjuhën serbe priren të publikojnë më së shumti dezinformata (12%), teori konspirative (8%) dhe manipulim të fakteve (8%) për zhvillimet në ndërlidhje me Kosovën.




Fig 16. Publikimet keqinformuese të mediave reale në gjuhën shqipe dhe serbe në bazë të kategorive të keqinformimit gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

Mediat reale në gjuhën shqipe, gjatë kësaj periudhe kanë prirje të krijojnë e shpërndajnë më shumë përmbajtje keqinformuese për kronikën e zezë (26%) dhe fushën sociale (12%) se sa në fushën politike (11%). Nga ana tjetër,

mediat reale në gjuhën serbe, në këtë periudhë, kanë shpërndarë kryesisht keqinformime për Kosovën pikërisht në fushën politike me 19% dhe të sigurisë me 16%.




Fig 17. Publikimet keqinformuese të mediave reale në gjuhën shqipe dhe serbe në bazë të fushave tematike gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmujore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Gjatë periudhës paraprake gjashtëmujore[25] (korrik-dhjetor 2022), mediat ishin matur duke i kategorizuar sipas aspektit gjeografik, në bazë të vendit ku janë të regjistruara si subjekte juridike (media vendore, rajonale, vendore/rajonale, ndërkombëtare dhe mediat në gjuhën shqipe të menaxhuara nga aktivistë të diasporës).[26] Edhe në këtë rast, krahasimi mes dy periudhave gjashtëmujore (shih Figurën 18) bëhet vetëm për mediat reale, sepse për publi-

-kuesit e tjerë, si portalet e dyshimta mungojnë informata për vendin e origjinës, ndërsa mediat sociale në periudhën paraprake gjashtëmujore nuk janë monitoruar.

Edhe në atë periudhë (korrik-dhjetor 2022), mediat reale vendore (bëhet fjalë për media të Kosovës) kishin publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 52%, pasuar nga mediat reale rajonale me 39%, ku poth-

[25] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022, f. 19. Prishtinë: ADS / hibrid.info.

[26] Përkufizimi dhe domethënia e këtyre llojeve të publikuesve shpjegohen në fjalorth.

-uajse të gjitha prej tyre janë nga Serbia, si dhe mediat vendore/rajonale me 6%. Media të tjera reale, si ato në gjuhën shqipe nga diaspora dhe mediat ndërkombëtare kishin shumë më pak publikime keqinformuese prej rreth 3%.

Ndërkaq, në këtë periudhë gjashtëmujore (janar-qershor 2023), mediat vendore janë zëvendësuar me 'mediat në gjuhën shqipe' dhe mediat rajonale me 'mediat në gjuhën serbe' për shkak se mediat rajonale, të cilat krijojnë e shpërndajnë keqinformime për

Kosovën, janë kryesisht mediat në gjuhën serbe. Krahasimi i të dhënave tregon se gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore ka pasur rritje të theksuar të publikimeve keqinformuese nga mediat reale në gjuhën shqipe prej 65% (rritje prej 13% me periudhën paraprake), kurse përmbajtjet keqinformuese të shpërndara nga mediat reale në gjuhën serbe kanë pësuar një rënie të lehtë nga 39% në 35% (rënie prej 4% me periudhën paraprake).




Fig 18. Publikimet keqinformuese të mediave reale në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera gjatë dy periudhave gjashtëmujore

6. LLOJET E MEDIAVE SOCIALE

Në këtë raport gjashtëmujor për herë të parë analizohen të dhëna më të detajuara sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues për Kosovën në mediat sociale nga publikues të ndryshëm. Këtu shqyrtohen vetëm artikujt e publikuar në mediat sociale (pa i përfshirë mediat reale dhe portalet e dyshimta, të cilat u analizuan në seksionin me titull “Llojet e publikuesve të keqinformimit”). Në raportin e parë për periudhën paraprake (korrik-dhjetor 2022) nuk ishin analizuar këto të dhëna sepse

“hibrid.info” ka filluar të monitorojë përmbajtjet keqinformuese në mediat sociale nga muaji janar 2023.

Gjatë kësaj periudhe, Facebook ka qenë media kryesore sociale për shpërndarjen e artikujve keqinformues lidhur me ngjarjet në Kosovë prej 60%. Ajo pasohet nga Tik Tok me 34%, Mediat tjera sociale, si Twitter me 3%, Reddit me 1%, Telegram me 1% dhe YouTube me 1% kanë dukshëm më pak publikime keqinformuese për këtë periudhë.




Fig 19. Publikimet keqinformuese në mediat sociale gjatë periudhës gjashtëmujore (janar-qershor 2023)

Llojet e publikuesve në mediat sociale

Përveç mediave sociale, në këtë raport hulumtohet edhe ndërveprimi në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues. Kjo është një risi tjetër e platformës "hibrid.info" për të ofruar të dhëna sa më të detajuara dhe për të thjeshtësuar ndikimin e mediave sociale në keqinformim dhe çrregullimin informativ në hapësirën digjitale në përgjithësi.

Analizimi i publikuesve në mediat sociale bëhet përmes këtyre kategorive: faqeve, llogarive, profileve, mediave,

faqeve zyrtare dhe kanaleve të ndryshme që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale, të cilët i shfrytëzojnë ato për përhapjen e keqinformimit në varësi të zhvillimeve rreth Kosovës.

Figura në vijim tregon se faqe të ndryshme në Facebook kanë përhapur më së shumti përmbajtje keqinformuese për këtë periudhë prej 50%. Ajo pasohet nga llogaritë në TikTok me 27%, ndërsa rreth 23% e keqinformimeve tjera janë shpërndarë nga publikues të ndryshëm në mediat tjera sociale.




Fig 20. Publikuesit e artikujve keqinformues në mediat sociale gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

Në krahasim me mediat reale dhe portalet e dyshimta, në mediat sociale janë publikuar më së shumti lajme të rreme, mashtrime, dezinformata dhe publikime clickbait (shih Figurën 12). Pothuajse të gjithë artikujt keqinformues në mediat sociale janë

krijuar e shpërndarë në gjuhën shqipe.

Në vijim analizohen mediat sociale në ndërlidhje me kategoritë e keqinformimit dhe fushat tematike të keqinformimit të shpërndara nga publikuesit në këto media.

01. Facebook

Publikuesit në Facebook kanë krijuar e shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese të vlerësuara si mashtrim me 17%, dezinformata me 15% dhe clickbait me 13%, të cilat pasohen nga artikuj me motive të lajmeve të rreme me 6% etj. Përhapja e publikimeve keqinformuese në Facebook kryesisht është bërë në fushën sociale prej 22%, të politikës me 11% dhe kronikës së zezë me 8%, ndërsa në përqindje më të vogël për siguri prej 6%.


02. TikTok

Numri më i madh i keqinformimeve në TikTok ka qenë për lajmet e rreme me 21% dhe në kategori të tjera, si teori konspirative (6%), mashtrim (4%) dhe dezinformata (2%). Për dallim prej publikuesve në Facebook, në TikTok, gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, janë publikuar kryesisht shtrembërime politike me 10% që kanë dominuar më së shumti dhe siguria me 7%. Kurse, artikujt keqinformues për kronikën e zezë dhe çështjet sociale janë në përqindje shumë më të ulët, me 3% secila prej tyre.

03. Twitter, YouTube dhe Reddit

Publikuesit në mediat tjera sociale, si Twitter (3%), Reddit (1%), Telegram (1%) dhe YouTube (1%) kanë shpërndarë shumë më pak artikuj keqinformues në krahasim me Facebook dhe TikTok. Këto dy të fundit vazhdojnë të jenë mediat sociale me përdorimin më të gjerë në Kosovë, prandaj ka dukshëm më pak përmbajtje në mediat tjera sociale.

Kategoritë e keqinformimit



Fushat tematike të keqinformimit





Fig 21. Publikimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale në bazë të kategorive të keqinformimit dhe fushave tematike gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

7. INSTITUCIONET DHE PERSONALITETET MË TË PËRFOLURA

Monitorimi i keqinformimit ka treguar se institucionet politike dhe të sigurisë, si dhe personalitetet politike janë ndër më të përfolurit gjatë kësaj periudhe.

Kjo tendencë vërehet veçanërisht tek institucionet e përfolura, ku Policia e Kosovës me 30% është renditur e para prej institucioneve, e cila është përfolur më së shumti nga mediat në gjuhën serbe (62%) sesa publikuesit në gjuhën shqipe (38%), në raportimet keqinformuese për zhvillimet në veriun e Kosovës. Gjithashtu, Policia e Kosovës është përfolur edhe në ndërlidhje me Listën serbe dhe Zyrën për Kosovë në Qeverinë serbe nga mediat në gjuhën serbe. Ajo pasohet nga disa keqinformime për NATO-n me 11%, Qeverinë e Kosovës me 5% dhe institucionet të tjera të paraqitura në Figurën 22.

Prej personaliteteve, më i përfoluri është kryeministri i Kosovës, Albin Kurti nga 27% e publikimeve. Kurti, si personalitet me peshë, duke qenë në krye të Qeverisë së Kosovës, më së shumti është përfolur nga mediat në gjuhën serbe (51%) sesa publikuesit në gjuhën shqipe (46%). Mediat në gjuhën serbe, përmes artikujve keqinformues të pabazuar në fakte, kanë përfolur Kurtin lidhur me Asociacionin e komunave me shumicë serbe, veriun e Kosovës, komunitetin serb në Kosovë etj. Kurse, artikujt keqinformues të shpërndara nga mediat në gjuhën shqipe, kanë përfolur Kurtin për krime të luftës, raportet Kosovë-SHBA, si dhe ato ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e për tema të tjera. Personalitete të tjera të përfolura janë Luiz Ejlli me 4%, Vedat Muriqi me 4%, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama me 3% dhe personalitete të tjera.






Fig 22. Institucionet dhe personalitetet më të përfolura nga publikimet keqinformuese të mediave gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar-qershor 2023)

Krahasimi mes dy periudhave gjashtëmuajore (korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023):

Krahasimi ndërmjet dy periudhave gjashtëmuajore tregon se institucionet politike dhe të sigurisë kanë dominuar edhe në periudhën korrik-dhjetor 2022, ku Policia e Kosovës është institucioni kryesor i përfolur. Dallimi është në përqindje (nga 9% në periudhën paraprahe, në 30% në këtë periudhë), ku

vërehet rritje e dukshme keqinformimeve që për fokus kanë pasur Policinë e Kosovës në këtë periudhë. Institucione të tjera të përfolura në mes të dyja periudhave janë pothuajse të njëjta (me disa përjashtime).




Fig 23. Institucionet më të përfolura nga publikimet keqinformuese të mediave gjatë dy periudhave gjashtëmuajore

Kryeministri Kurti ka qenë më i përfoluri edhe gjatë periudhës paraprake prej 14% të publikimeve kundrejt 27% në këtë periudhë. Me këtë vërehet rritje e artikujve prej 13% për këtë periudhë, në të cilat Kurti vendoset në kontekste të ndryshme prej keqinformimeve të

publikuesve në gjuhën shqipe dhe serbe në krahasim me periudhën paraprake. Dallimi ndërmjet periudhës së parë (korrik-dhjetor 2022) dhe periudhës së dytë gjashtëmujore (janar-qershor 2023) qëndron tek përvoja e personaliteteve të tjera.




Fig 24. Institucionet më të përfolura nga publikimet keqinformuese të mediave gjatë dy periudhave gjashtëmujore

V. PRAKTIKA DHE MJEDISI GAZETARESK: RRETHANAT DHE KONTEKSTI

Mediat kosovare ballafaqohen me probleme dhe sfida të ndryshme të operimit si media funksionale dhe profesionale. Viteve të fundit janë krijuar një numër i madh mediave në Kosovë, përfshirë televizione dhe sidomos media online, ndërsa llogaritet se 468 media janë të regjistruara si subjekte juridike[27]. Që nga pandemia COVID-19 në Kosovë nuk ka më gazeta të shtypura dhe si pasojë e vështirësive financiare janë mbyllur duke kaluar në hapësirën online. Aktualisht, mjedisi mediatik në Kosovë përbëhet prej televizioneve, radiove dhe mediave online, por edhe nga aktiviteti i faqeve të ndryshme të mediave kosovare në mediat sociale. Padyshim numri më i madh i tyre janë media online dhe prej 468 mediave të regjistruara si subjekte juridike, vetëm 50 prej tyre janë të anëtarësuar në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës[28] dhe nuk janë të regjistruara as si subjekte juridike në institucionet gjegjëse të Kosovës[29].

Derisa televizionet janë më të kujdesshme në respektimin e etikës gazetareske dhe informimin e drejtë të publikut, shpërndarja më e madhe përmbajtjeve keqinformuese, dezinformative dhe lajmeve të rreme në Kosovë ndodh kryesisht nga një

pjesë e madhe e mediave që operojnë në hapësirën online dhe rrjedhimisht bëjnë shkelje të etikës dhe standardeve të gazetarisë profesionale[30].

Shumica e mediave online në Kosovë funksionojnë me redaksi të vogla, jo më tepër se me pesë punonjës dhe, për më tepër, u mungojnë përvoja dhe kapacitetet profesionale lidhur me publikimin e përmbajtjeve të sakta në funksion të informimit të drejtë të publikut. Në mungesë të këtyre kapaciteteve dhe njohurive të nevojshme, një pjesë e mediave dhe gazetarëve i ekspozohen përmbajtjeve keqinformuese dhe dezinformuese, të cilat shpërndahen tek publiku[31]. Mediat ballafaqohen me numër shumë të vogël të redaktorëve, lektorëve dhe praktika të paqarta të respektimit të etikës dhe gazetarisë sa i përket publikimit të lajmeve jashtë vendit dhe përmirësimit apo ndryshimit të lajmeve në procesin e publikimit të tyre etj.[32]

Hulumtimet e vitit 2022 tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e mediave online mund të jenë të papërgatitura për njohjen dhe zbulimin e përmbajtjeve keqinformuese.[33] Në këtë rast, parandalimi dhe luftimi i përmbajtjeve keqinformuese dhe

[27] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022, f. 21. Prishtinë: ADS / hibrid.info.

[28] Po aty, f. 22.

[29] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[30] Po aty.

[31] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022, f. 21. Prishtinë: ADS / hibrid.info.

[32] Ondozi, Q. (2022). Keqinformimi, dezinformimi dhe lajmet e rreme në mediat online në Kosovë, fq. 8-9. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës.

[33] Po aty, f. 9.

dezinformuese bëhet edhe më i vështirë në kushtet e mungesës së njohurive mbase minimale për kontroll të fakteve nga ana e vet mediave online (mbase jo të gjitha, por një pjesë e rëndësishme e tyre) dhe për t'iu kundërvënë keqinformimit.

Një nga problemet kryesore të mediave në Kosovë, qoftë në aspektin ligjor apo atë praktik, është çështja e transparencës së pronësisë dhe ajo financiare, e cila ka ndikuar edhe në çrregullimin informativ.[34] Pronësia e mediave nuk është e rregulluar më legjislacionin aktual në Kosovë në fushën e mediave dhe njohës të mediave kanë sugjeruar se urgjentisht duhet të ndërtohet baza ligjore për qartësimin e transparencës dhe pronësisë së mediave.[34] Ekspertë të mediave, po ashtu, kanë konstatuar se veçanërisht çështja financiare e mediave është prej sfidave kryesore sepse kjo nxit këto të fundit të jenë nën ndikim të grupeve të ndryshme të interesit, siç janë bizneset, partitë politike, pushteti etj., dhe të shtyjnë agjenda të ndryshme financiare e politike të këtyre grupeve të interesit për të përfituar financiarisht ose në forma të tjera.[35] Kjo, sipas tyre, mund të vërehet me theks të veçantë gjatë kohës së zgjedhjeve në Kosovë, përkatësisht raportimit të mediave gjatë fushatave parazgjedhore[36].

Përveç kësaj dhe problemeve tjera të identifikuar më lartë, disa nga shkakta-

-rët tjerë të çrregullimit informativ janë burimet e paqarta / panjohura të financimit të mediave (kryesisht atyre online) dhe importimi i narrativave të huaja në Kosovë nga mediat vendore, veçanërisht të atyre mediave serbe të afërta me pushtetin në Serbi dhe mediave ruse, të cilat kanë synim propagandimin qoftë edhe përmes dezinformimit.[37] Sa i përket mediave ruse në mënyrë specifike, edhe pse zyrtarisht të bllokuara për audiencën digjitale të Kosovës, "Sputnik" dhe "RT Balkan", tash e një kohë janë të qasshme për secilin që kërkon t'i vizitojë këto ueb-faqe në internet. Derisa "Sputnik", për audiencën digjitale të Kosovës është e qasshme në shërbimin ndërkombëtar dhe në gjuhën serbe, mediumi tjetër "Russia Today" ofrohet vetëm në shërbimin për Ballkanin - "RT Balkan".[38] Rrjedhimisht, mediat po i ndërrojnë domenet e tyre dhe po operojnë të papenguar[39]. Ndonëse Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim për ndalimin e mediave pro-qeveritare ruse në Kosovë, pas hulumtimeve të kryera nga hybrid.info është verifikuar se qasja në këto dy portale ruse, tashmë është e mundshme. Që nga muaji mars 2022, Qeveria e Kosovës kishte ndërmarrë një sërë sanksionesh në raport me Rusinë, të vendosura nga BE-ja dhe SHBA-ja, ndaj veprimeve destabilizuese të Ruisë lidhur me situatën në Ukrainë, ndër të cilat parashihej edhe ndalimi i transmetimit të mediave propaganduese të Ruisë në Kosovë[41].

[34] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hybrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[35] Po aty.

[36] Po aty.

[37] Po aty.

[38] Bokshi, A. (2023). Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022, f. 22. Prishtinë: ADS / hybrid.info

[39] Shih artikullin "Mediat e (zh)bllokuara ruse" publikuar nga "hybrid.info", 25 maj 2023.

[40] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hybrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[41] Shih artikullin "Mediat e (zh)bllokuara ruse" publikuar nga "hybrid.info", 25 maj 2023

VI. RREGULLIMI DHE VETËRREGULLIMI I MEDIAVE

Në Kosovë ekzistojnë dy mekanizma kryesorë për rregullimin/vetërregullimin e mediave: i) Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) si mekanizëm rregullues i mediave dhe ii) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) si mekanizëm vetërregullues i mediave.

KPM-ja është organ i pavarur me kompetenca për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, si dhe rregullon të drejtat, detyrimet, si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale[42], që nënkupton radiot dhe televizionet në Kosovë. Ndër përgjegjësitë kryesore të këtij mekanizmi rregullues përfshihen licencimi i transmetuesve publikë e privatë, vendosjen e sanksioneve për subjektet e licencuara, të cilat bëjnë shkeljen e rregulloreve të KPM-së apo kushteve të licencës, si dhe i raporton Kuvendit të Kosovës[43].

Ndërkaq, KMSHK-ja funksionon si organizatë joqeveritare[44], e themeluar më 2005 me ndihmën e OSBE-së, është mekanizëm vetërregullues për mediat e shkruara[45]. Marrë parasysh se prej vitit

2020 nuk ka më gazeta të shtypura, fokusi i KMSHK-së është tek mediat online në vend. Ndër qëllimet e KMSHK-së është mbrojtja e qytetarit nga shkrimet e pavërteta dhe të mbrojtja e gazetarët nga ankesat e pambështetura[46]. KMSHK-ja është adresa ku palët e interesuar dhe qytetarët mund të ankohen për mediat që i mbulon ky mekanizëm vetërregullues në rastet kur ekzistojnë dyshime se ato kanë shkelur Kodin e KMSHK-së[47].

Megjithatë, puna e këtyre dy mekanizmave të ndryshëm është ballafaquar me probleme të ndryshme. Sa i përket KPM-së, KE-ja më 2022 ka kritikuar se mungesa e stafit dhe burimeve adekuate kanë vështirësuar punën e saj për të ushtruar kompetencat e saj si organ i pavarur dhe ka rekomanduar se vendimmarrja e këtij mekanizmi duhet të jetë transparente dhe gjithëpërfshirëse[48]. Gjithashtu, monitorimi i mediave (televizioneve/radiove) nga KPM-ja është i kufizuar sepse përmbajtjet mediale të monitoruara nga ky mekanizëm janë vetëm në rastet e fushatave parazgjedhore, por jo edhe

[42] Neni 3, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

[43] Po aty.

[44] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[45] Shih rubrikën "Për ne" në ueb-faqen e KMSHK-së.

[46] Po aty.

[47] Shih rubrikën "Parashtimi i ankesës" në ueb-faqen e KMSHK-së.

[48] European Commission. (2022). Kosovo 2022 Report, f. 94. Brussels: European Commission.

përmbajtjet tjera[49]. Në këtë rast, ekspertë të mediave rekomandojnë dhe bëjnë thirrje që KPM-ja të monitorojë edhe përmbajtjet e tjera, të paktën debatet politike në të gjitha televizionet kombëtare, të cilat po konsiderohen si një mjet tjetër i shpërndarjes së përmbajtjeve keqinformuese tek publiku kosovar[50]. Ndërkaq, integriteti i KPM-së është vënë në pikëpyetje[51] nga dyshimet dhe akuzat për korrupsion të ish-zyrtarëve të lartë të këtij institucioni më 2021, të cilët janë nën hetime[52] nga institucionet e drejtësisë[53] në Kosovë.

Siç dihet, mediat online në Kosovë nuk janë të rregulluara në aspektin ligjor dhe aktualisht janë vetëm subjekt i vetërregullimit nga KMSHK-ja dhe anëtarësimi në këtë të fundit është vullnetar nga mediat online[54]. Rrjedhimisht, këto media nuk janë të rregulluara as me Ligjin aktual të KPM-së dhe nuk janë në kompetencën e kësaj të fundit. KE-ja vazhdimisht ka rekomanduar që të ndryshohet Ligji për KPM-në dhe të harmonizohet me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audio-vizuale[55], e cila ka pësuar ndryshime në vitin 2018, duke rregulluar funksionimin e shërbimeve shpërndarjes dhe operatorët tjerë që

pavarësisht teknologjisë së përdorur audio-vizuale[56]. Qeveria e Kosovës ka nisur më 2020[57] nismën për ndryshimin e Ligjit aktual të KPM-në me qëllim të harmonizimit me Direktivën përkatëse të BE-së, por që nga atëherë deri më tash (qershor 2023), ky projektligj nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Kosovës. Ekspertët e mediave kanë kritikuar se procesi i ndryshimit të ligjit nuk ka qenë transparent, sepse në grupin punues kanë qenë të përfshirë vetëm KPM-ja dhe Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, por jo edhe mediat, shoqëria civile dhe ekspertë të mediave, ndërsa ata janë ftuar vetëm në dy dëgjime publike për projektligjin më 2020 dhe 2021[58]. Por, në fund të vitit 2021, projektligji ishte publikuar në platformën e konsultimeve publike, ku të gjitha palët kanë pasur mundësi të dërgojnë komente në përmbajtjen e tij[59].

Projektligji i ri i hartuar nga Qeveria, ndonëse ende nuk është miratuar dhe nuk ka hyrë në fuqi, është i harmonizuar me Direktivën e BE-së, duke përfshirë në kuadër të kompetencave të KPM-së edhe rregullimin e platformave për shkëmbimin e videove, operatorëve të shpërndajnë ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale.[60] Tabela në vij-

[49] Po aty, f. 34.

[50] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[51] Po aty.

[52] Makshana, L. (19 janar 2022). Apeli konfirmon aktakuzën ndaj ish-kryeshefit të KPM-së që ngarkohet për korrupsion. Betimi për Drejtësi.

[53] Merlaku, A. (3 maj 2023). Dëgjohen disa audio-incizime në gjykimin për korrupsion ndaj ish-kryeshefit të KPM-së. Betimi për Drejtësi.

[54] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[55] Shih Direktivën e BE-së.

[56] Shih Nenin 1 të Direktivës së BE-së për përkufizimin e mediave audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe ato që shpërndajnë përmbajtje në hapësirën online.

[57] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[58] Po aty.

[59] Shih Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave në platformën e konsultimeve publike.

[60] Neni 4, Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave.

-im tregon se si janë të rregulluara mediat me Ligjin në fuqi të KPM-së dhe

ndryshimet që pritet të sjellë projektligji i ri (nëse miratohet siç është aktualisht):

Rregullimi i mediave në Kosovë sipas Ligjit aktual për KPM-në:

Rregullimi i mediave në Kosovë sipas ndryshimeve në Projektligjin e ri për KPM-në:

Paragrafi
1, Neni 3:

KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Paragrafi
2.1, Neni 4:

KPM rregullontë drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio, audiovizuale, shërbimet e platformës për shkëmbimin e videove, operatorët e shpërndarjes si dhe operatorët e tjerë të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale.

Paragrafi
2.1, Neni 3:

KPM licencon transmetuesit publikë e privatë dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuara të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit, si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.

Paragrafi
2.2, Neni 3:

KPM lëshon leje për ofruesit e shërbimeve audio, audiovizuale, platformat për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes, operatorët e rrjetit dhe operatorët e multipleksit.

Këmbëngulja e BE-së për ndryshimin dhe harmonizimin e Ligjit për KPM-së me Direktivën e BE-së dëshmon se ajo preferon që KPM-ja të ketë nën kompetenca të veta rregullimin dhe licencimin e mediave online, në rekomandimin e KE-së tekstualisht thuhet se "amendamenti i Ligjit për KPM-në, i cili aktualisht është në proces, duhet të harmonizohet tutje me Direktivën e Shërbimeve të Mediave

Audio-vizuale për të zgjeruar kompetencat e (KPM-së) tek mediat audio-vizuale online[61]. Por, kjo pritet të hasë në rezistencë dhe kundërshti tek gazetarët, komuniteti mediatik dhe shoqëria civile në Kosovë në arsyetimin se Kosova nuk ka kushte për zbatimin e këtyre ndryshimeve të propozuara, si pasojë e kapaciteteve të pamjaftueshme profesionale dhe mungesës së ekspertizës së KPM-së në

[61] European Commission. (2022). Kosovo 2022 Report, f. 94. Brussels: European Commission.

zbatimin e këtyre dispozitave ligjore [62]. Ekspertë të mediave dhe hapësirës digjitale theksojnë rëndësinë e fuqizimit të KMSHK-së si organ vetërregullues[63] dhe që mediat online të vazhdojnë të mbesin subjekt vetërregullues i KMSHK-së[64].

Lidhur me KMSHK-në si organ vetërregullues i mediave online, ajo ballafaqohet me sfidat e qëndrueshmërisë financiare, siç konstatohet nga ekspertë të mediave[65] dhe raporti i Komisionit Evropian për Kosovën[66], i cili rekomandon që rregullatorët e mediave të kenë burime adekuate me qëllim të përmbushjes së mandatit të tyre në mënyrë të pavarur. Një nga format e sigurimit të qëndrueshmërisë financiare për KSHMK-në, njohës të mediave përmendin ndarjen e një buxheti nga shteti, (Qeveria/Kuvendi), për zhvillimin e kapaciteteve në monitorimin e mediave online, veçanërisht sa i përket parandalimit dhe luftimit të keqinformimit[67], por në këtë rast duhet të kihet kujdes për shmangien e keqpërdorimeve të mundshme në shpenzimin e buxhetit. Ndërkohë, shqetësuese mbetet fakti i rritjes së numrit të mediave online në Kosovë që nuk janë të regjistruara në KMSHK[68].

Si shembull i suksesshëm i vetërregullimit të mediave online në hapësirën digjitale, nga komuniteti mediatik në Kosovë përmendet rasti i

vetërregullimit të mediave në Finlandë[69]. Organi vetërregullues i mediave në Finlandë është Këshilli për Mjetet e Komunikimit Masiv (Council for Mass Media - CMM)) i cili ishte themeluar në vitin 1968 nga publikuesit dhe gazetarë finlandezë,[70]. Anëtarësimi i mediave në CMM është vullnetar dhe pothuajse 95% e gazetarëve që punojnë në mediat finlandeze janë anëtarë të këtij mekanizmi dhe kanë pranuar Kodin e Etikës së CMM-së[71]. Përveç që financohet nga pagesat e anëtarësisë vjetore të anëtarëve të mekanizmit vetërregullues (që në këtë rast janë media), CMM-ja mund të pranojë financim edhe nga Qeveria finlandeze në formë të subvencionit nga Grupi Menaxhues i këshillit (ky trup i këshillit mbikëqyrë shpenzimin e buxhetit të CMM-së dhe miraton buxhetin e saj) dhe me pëlqimin e Bordit pranon donacione dhe trashëgimi në mbështetje të aktiviteteve të këshillit[72].

Rasti i Finlandës, si vend anëtar i BE-së, në kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe me theks të veçantë Kosovës mund të jetë ideal duke i ditur problemet me të cilat ballafaqohet sektori i mediave në vend. Kjo do të mund të shërbejë si rast i mirë për ndërtimin dhe konsolidimin e formave me adekuate të rregullimit dhe vetërregullimit të mediave në përshtatje me rrethanat dhe kontekstin mediatik në Kosovë.

[62] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[63] Po aty.

[64] Po aty.

[65] Po aty.

[66] European Commission. (2022). *Kosovo 2022 Report*, f. 93. Brussels: European Commission.

[67] Grupi i fokusit me ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 22 maj 2023.

[68] European Commission. (2022). *Kosovo 2022 Report*, f. 34. Brussels: European Commission.

[69] Po aty.

[70] Shih rubrikën "Council for Mass Media" në ueb-faqen e CMM-së.

[71] OECD iLibrary. (2021). 4. *Media freedoms and digital rights in Finland*.

[72] Neni 23, *Marrëveshja Themelore e CMM-së*. Për më shumë detaje lidhur me funksionin dhe veprimtarinë këtij mekanizmi vetërregullues të mediave në Finlandë, shih ueb-faqen e CMM-së këtu: <https://jsn.fi/en/>.

Monitorimi i gjendjes së çrregullimit informativ në Kosovë për periudhën janar-qershor 2023 ka dëshmuar për vazhdimësinë e trendit nga periudha paraprake gjashtëmujore se temat politike lidhur me zhvillimet në Kosovë përdoren më së shumti për krijim dhe shpërndarje të përmbajtjeve keqinformuese nga publikues të ndryshëm dhe media online.

Tema e veriut të Kosovës, e cila është riaktualizuar muajve të fundit, është tema kryesore politike më së shumti e trajtuar nga publikimet keqinformuese gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Pjesa më e madhe e publikimeve keqinformuese për veriun janë vlerësuar si “dezinformata” dhe media në gjuhën serbe kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti dezinformata lidhur me zhvillimet në veri të Kosovës.

Publikime të tilla të pabazuara në fakte janë pjesë e narrativave dezinformuese që bëhen kryesisht nga mediat në gjuhën serbe të afërta me pushtetin në Serbi për çështje politike e të sigurisë në Kosovë lidhur me veriun e Kosovës, komunitetin serb në Kosovë, pretendime të pasakta për kërcënim të serbëve nga shteti i Kosovës etj. Për më tepër, të gjitha publikimet e mediave në gjuhën serbe në ndërlidhje me ngjarjet në Kosovë janë në fushën politike dhe të sigurisë. Në anën tjetër, edhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar në mënyrë të konsiderueshme dezinformata, megjithatë vërehet se ato kanë shpërndarë dezinformata më tepër për çështje sociale sesa politike.

Ndërkohë, përmbajtjet keqinformuese në fushën sociale janë në vendin e dytë pas politikës dhe të gjitha prej tyre janë krijuar dhe shpërndarë nga media dhe publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe. Publikimet keqinformuese në fushën sociale janë vlerësuar në këto dy kategori të keqinformimit: “clickbait” dhe “mashtim”. Kjo dëshmon për tendencën e publikuesve në gjuhën shqipe, kryesisht nga Kosova, për të shpërndarë përmbajtje me qëllim të rritjes së audiencës online. Një gjetje tjetër në mbështetje të këtij konstatimi është se shumica dërrmuese e shtrembërimeve që kanë trajtuar çështjet sociale janë publikuar nga faqe dhe profile të ndryshme në mediat sociale, si dhe portalet e dyshimta. Rrjedhimisht, publikuesit që shpërndajnë artikuj të tillë keqinformues nuk e kanë domosdoshmërisht tendencën ose qëllimin që të keqinformojnë apo dezinformojnë, por e bëjnë kryesisht për mundësinë e përfitimeve

financiare përmes klikimeve. Metoda e keqinformimit përmes kategorisë “clickbait” ka dominuar më së shumti në këtë periudhë dhe përveç fushës sociale, publikuesit në gjuhën shqipe janë shërbyer dukshëm edhe me artikuj keqinformues për kronikën e zezë që janë vlerësuar si “clickbait” në masën më të madhe.

Në kuadër të raportit trajtohen gjerësisht edhe çështje të tjera të keqinformimit, siç janë fushat e keqinformimit, llojet e publikuesve, përfshirë mediat sociale, që në masë të madhe kanë shërbyer për shpërndarjen e shtrembërimeve të informacioneve të ndryshme lidhur me ngjarjet në Kosovë.

Në raport konstatohet se sfidat e identifikuar më herët, siç janë mangësitë në kornizën ligjore të Kosovës për rregullimin / vetërregullimin e mediave nuk janë adresuar ende nga institucionet e Kosovës, pavarësisht kritikave nga organizatat ndërkombëtare. Pos kësaj, edhe mekanizmat që merren me media përballen me mungesë kapacitetesh (profesionale dhe financiare) të cilat pamundësojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të mediave që veprojnë në hapësirën online. Edhe mediat, veçanërisht ato online, ballafaqohen me mungesë të burimeve e njohurive profesionale për kontroll të fakteve dhe identifikim të përmbajtjeve keqinformuese dhe narrativave dezinformuese, gjë që e sfidon në vetvete parandalimin dhe luftimin efikas të çrregullimit informativ në vend.

REKOMANDIMET

Të miratohet Ligji i ri për Komisionin e Pavarur për Media duke përfillur rekomandimet e Komisionit Evropian të përsëritura ndër vite. Megjithatë, deri të miratimi i ligjit nga Kuvendi i Kosovës, duhet të sigurohet transparencë në proces. Mediat, ekspertët e mediave dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit të ligjit nga legjislativi me qëllim të pjesëmarrjes dhe kontributit të drejtpërdrejtë të tyre sa i përket përmbajtjes së ligjit. Kërkesat e mediave për rregullimin apo vetërregullimin e mediave duhet të merren parasysh gjatë finalizimit të ligjit para miratimit të tij.

Pronësia, transparenca dhe financimi i mediave duhet të rregullohet qoftë me Ligjin e ri të Komisionit të Pavarur për Media, qoftë me një ligj të ri për të shmangur vakumin që ekziston në këtë fushë në aspektin ligjor, por për më tepër për t'i ikur keqpërdorimeve mundshme dhe kjo tërthorazi do të shmangte keqinformimin dhe dezinformimin nga ana e gazetarëve dhe mediat.

Komisioni i Pavarur për Media të shtojë kapacitetet profesionale për monitorimin në baza ditore të debateve televizive me karakter politik e të sigurisë në televizionet kombëtare të Kosovës, të cilat sipas rasteve kanë përmbajtje keqinformuese nga pjesëmarrësit e këtyre debateve (analistë, publicistë, komentues të ngjarjeve politike etj.). Edhe shoqëria civile dhe platformat për kontroll të fakteve në Kosovës duhet të monitorojnë debatet televizive në Kosovë për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe keqinformimit. Duke qenë se debatet televizive janë njëra prej burimeve të informacionit nga ku audienca informohet në masë të madhe, ato rrjedhimisht krijojnë impakt të dukshëm tek publiku.

Të ketë fushata informative me përfshirjen e institucioneve rregulluese e vetërregulluese të mediave, mediave dhe shoqërisë civile për edukimin medial të popullatës për dallimin e lajmeve të vërteta nga përmbajtjet keqinformuese, dezinformatat dhe lajmet e rreme në mënyrë që palët dhe audienca e gjerë të kuptojnë rolin e këtyre mekanizmave.

Kërkohet nga institucionet qeveritare, përkatësisht Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe mekanizmat përcjellës që urgjentisht të angazhohen për përfshirjen e lëndës së edukimit mediatik dhe digjital në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës duke parë se shtrembërimi informativ është tashmë realitet i cili nuk do të zhdukët shpejtë.

Platformat për kontrollin e fakteve në Kosovës të jenë edhe më aktive në identifikimin e përmbajtjeve keqinformuese dhe të rreme nga mediat dhe publikuesit e ndryshëm në Kosovë për të ndikuar më rritjen e vetëdijes së lexuesve dhe përdoruesve të hapësirës online për rrezikun e dezinformatave dhe lajmeve të rreme.

Mediat kosovare të vendosin kritere obliguese për gazetarët në ndjekjen e trajnimeve intensive dhe të vazhdueshme lidhur me metodat dhe teknikat e identifikimit e zbulimit të përmbajtjeve keqinformuese, dezinformatave dhe lajmeve të rreme për të zhvilluar kapacitetet dhe shkathtësitë në verifikimin e informatave.

METODOLOGJIA DHE TERMINOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur metodat kuantitative dhe kualitative përmes një qasje të kombinuar metodologjike.

Në pjesën kuantitative përfshihet analiza e raporteve mujore monitoruese të platformës “hibrid.info” mbi keqinformimin, të publikuara gjatë periudhës gjashtëmujore janar-qershor 2023. Në këto raporte mujore janë trajtuar kontrollet e fakteve në baza të rregullta ditore nga “hibrid.info”.

Ndërsa, të dhënat kualitative janë marrë nga diskutimet intensive në grupin e fokusit me ekspertë të mediave, redaktorë dhe gazetarë me përvojë që ishte organizuar në muajin maj 2023. Kësaj i ka paraprirë edhe një punë hulumtuese përmes analizimit, shqyrtimit dhe konsultimit të kornizës ligjore në Kosovë për mediat, si dhe raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare mbi mediat në Kosovë e rajon. Po ashtu, edhe arkivat e mediave në Kosovë kanë shërbyer si një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport monitorues dhe hulumtues.

Baza e këtij raporti është ndërtuar nga gjetjet e raporteve mujore monitoruese dhe grupit të fokusit, që kanë shërbyer si burime për nxjerrjen e të dhënave primare. Ndërsa, gjetjet nga hulumtimi i materialeve të ndryshme, janë shfrytëzuar si të dhëna dytësore për të përforcuar analizën e burimeve primare.

Me qëllim të shmangies së keqinterpretimeve të disa nocioneve teknike-profesionale të përdorura në raport, sidomos sa i përket kategorive vlerësuese të keqinformimit dhe llojeve të publikueseve të përmbajtjeve keqinformuese, raporti ka ofruar shpjegimin praktik e konkret të këtyre nocioneve në kuadër të seksionit me titull “Fjalorthi”.

Fjalorthi

CLICKBAIT

"Clickbait" janë ato tekste titulli i të cilave nuk kanë asnjë bazë në përmbajtjen e tekstit vijues. Tekste dhe artikuj të tillë synojnë të tërheqin vëmendjen e lexuesit apo edhe konsumatorit (klikimin) me një titull sensacional duke premtuar përmbajtje që nuk ekziston në të vërtetë.

GABIMI

Vlerësimin "Gabim" e marrin raportet në media në të cilat redaksia e mediave bënë një gabim duke publikuar informacion të pasaktë ose duke transmetuar lajme të pavërtetuara nga një burim tjetër, pa qëllimin e qartë të dezinformimit të publikut.

RAPORTIM I NJËANSHËM

Vlerësim si "Raportim i njëanshëm" merr ai raport mediatik i cili vërehet se bënë favorizim të fakteve, qëndrime dhe përfundime që përputhen me një narrativë të veçantë, shpesh duke mos respektuar rregullin e kontaktit me palën tjetër kur bëhet fjalë për pretendime që janë të dëmshme për reputacionin e dikujt.

TEORI KONSPIRATIVE

Vlerësim si "Teori konspirative" marrin ato informacione të cilat shpërndajnë një përshkrim të rremë ose të paverifikueshëm të një dukurie, ngjarje ose një personi, duke e paraqitur atë si pjesë ose rezultat të një plani të fshehtë ("komplot"). Karakteristikë e tyre është paraqitja e një seri pretendimesh si fakte pa ofruar ndonjë provë të besueshme.

PSEUDOSHKENCË

Vlerësim si "Pseudoshkencë" merr ai informacion që përpiqet të paraqesë disa mendime, qëndrime, vlera ose gjetje të marra nga një metodë joshkencore dhe t'i paraqesë ato si zbulime shkencore ose fakte. Raporte të tilla keqinterpretojnë ose manipulojnë kërkimet shkencore ekzistuese, ose i referohen hulumtimeve që janë në kundërshtim me shkencën.

MANIPULIM I FAKTEVE

Vlerësimin si "Manipulim i fakteve" marrin ato raportime mediatike që përdorin fakte të njohura si të sakta, por i interpretojnë ato në mënyrë të shtrembëruara. Këto raporte zakonisht përdorin informacion të saktë për të nxjerrë përfundime ose pretendime të pasakta, duke drejtuar përfundimet e konsumatorëve të përmbajtjes së mediave në drejtim të gabuar.

DEZINFORMATATA

Vlerësimin si "Dezinformata" e merr ai raportim mediatik i cili në vete përmban një "miks" të burimeve të pasakta apo edhe përmbajtje gjysmë të vërtetë. Gjithashtu, ky vlerësim do të trajtojë raporte që kanë attribute të gabuara ose tituj që nuk pasqyrojnë tekstin për sa i përket saktësisë së informacionit.

SPINI

Vlerësimi "Spin" i jepet një raporti mediatik me të cilin autori përpiqet të largojë vëmendjen e publikut nga disa përmbajtje ose fakte të tjera që raportohen në media në atë kohë. Karakteristikë e raporteve të tilla në m të largojë vëmendjen, dhe e cila është e pafavorshme për disa akterë, kryesisht politikë.

LAJM I RREMË

Vlerësimin “Lajm i rremë” e marrin ato raportime mediatike që janë tërësisht prodhim i një mediumi i cili në vete përmban pretendime ose informacione të sajara. Pra, lajm i rremë mund të përcaktohet se është krijuar dhe shpërndarë me qëllim të dezinformimit të publikut, për të paraqitur një pretendim që është i rremë si fakt.

PËRMBAJTJE E PAVERIFIKUAR

Vlerësimi “I pa verifikuar” u bëhet atyre raporteve mediatike që nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për të konfirmuar pretendimet e bëra në raport, dhe të cilat nuk kanë mundur konfirmojnë të njëjtat për shkak të mungesës ose mos-posedimit të burimeve të besueshme.

SATIRA

Vlerësimi i “Satirës” përfshinë përmbajtjen e cila përdor lajme të paramenduar që përdorin satirën për të treguar realitetin. Ky është edhe një mënyrë e raportimit i cili nuk është problematik, nëse media arrin të argumentojë se bëhet fjalë për një përmbajtje satirike.

MEDIA REALE

Media reale janë ato që u dihet vendi i origjinës, që janë të regjistruara si entitete juridike, si biznese apo OJQ, që kanë të dhëna për dhe rreth aktivitetit të tyre siç është pronësia, menaxhmenti, impresumi, adresa, stafi dhe të tjera.

MEDIA SOCIALE

Mediat sociale përfshijnë llogarit, profilet, fun page, faqet zyrtare në Facebook, TikTok, Twitter etj.

PORTALE TË DYSHIMTA

Portale të dyshimta janë ato për të cilat mungojnë të dhënat për pronësinë, menaxhmentin, impresumin, adresën, stafin dhe të tjera, apo i kanë ato vetëm si të pjesshme.

PUBLIKIMET NË GJUHËN SHQIPE

Publikimet në gjuhën shqipe përfshijnë përmbajtjet e publikuara nga: i) mediat reale, ii) faqe dhe profile të ndryshme në mediat sociale dhe iii) portalet e dyshimta.

PUBLIKIMET NË GJUHËN SERBE

Publikimet në gjuhën serbe përfshijnë përmbajtjet e publikuara nga mediat reale në gjuhën serbe.



HIBRID.INFO

